



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKTVENDIM

Nr. 6909, Datë 28. 05 . 2025

PËR MIRATIMIN E PBA-së 2026-2028 TË BASHKISË LEZHË (FAZA E PARË).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.8, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”; Kryetari i Bashkisë, i paraqet projektin përkatës, Këshillit të Bashkisë Lezhë;

Për të vendosur:

- 1.Miratimin e PBA-së 2026-2028 të Bashkisë Lezhë për fazë e parë, sipas projektdokumentit të paraqitur të PBA-së (SMBV-në dhe relacionit përkatës), bashkëlidhur këtij projektvendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 6909/ Prot

Lezhë, më 28. 05 .2025

R E L A C I O N

**MBI PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR MIRATIMIN E PBA-së 2026-2028
PËR FAZËN E PARË**

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.8, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”; nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është përgatitur Projektdokument i Programit Buxhetor Afatmesëm (Sistemi i Menaxhimit Buxhetit Vendor dhe relacioni i detajuar) për fazën e parë, dokument i cili është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Në dokumentin e paraqitur, bashkëlidhur projekt-aktit është relacioni shpjegues për standardet, procedurën, afatet e ndjekura dhe të zbatuara në përgatitjen e PBA-së për fazën parë.

Por, në mënyrë të përmbledhur në këtë relacion po ju paraqesim të dhënat kryesore ekonomiko-financiare, si të ardhurat, shpenzimet dhe prioritetet e investimeve që do të realizohen gjatë viteve 2026-2028.

Më konkretisht të dhënat bazë janë:

Të ardhurat gjithsej sipas burimeve:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	2025		2026	Në % / 2025	2027	Në % / 2026	2028	Në % / 2027
		Plani	Rishikuar	Plani		Plani		Plani	
1	Të ardhurat vendore	1,313,447	1,313,447	1,200,606	91.4	1,209,885	100.8	1,219,596	100.8
a	Taksat vendore	871,110	871,110	879,253	100.9	881,408	100.2	884,028	100.3
b	Tarifat vendore	297,510	297,510	303,727	102.1	310,499	102.2	317,228	102.2
c	Të ardhura tjera	144,827	144,827	17,626	12.2	17,978	102.0	18,340	102.0
2	Taksat e ndara	81,040	81,040	82,073	101.3	83,756	102.0	85,751	102.4
3	Transf. Pakushtëzuar	558,296	558,296	580,070	103.9	607,310	104.7	634,887	104.5
4	Transferta Sektoriale	324,898	324,898	324,898	0	324,898	0	324,898	0
5	Të Trashëguara	0	337,573	0	0	0	0	0	0
T O T A L I		2,277,681	2,615,254	2,187,647	96.0	2,225,849	101.7	2,265,132	101.8

Referuar burimeve të mësipërme për vitin 2026 të ardhurat e veta janë 1,200,606 mijë lekë dhe zënë 54.9% të burimeve gjithsej, të ardhurat nga taksat e ndara janë 82,073 mijë dhe zënë

3.7% e burimeve gjithsej, Transferta e Pakushtëzuar është 580,070 mijë lekë dhe zënë 26.5% të burimeve gjithsej, ndërsa Transferta Sektoriale është 324,898 mijë lekë dhe zënë 14.9% e burimeve gjithsej.

Të ardhurat nga burimet e veta pësojnë këto ndryshime sipas viteve, konkretisht: në vitin 2026-ato ulen 8.6% në krahasim me vitin 2025, për arsye se ulen burimet e tjera (3% i të ardhurave nga tarifa e strehimit për ndërtimet e reja), në vitin 2027 rriten 0.8% në krahasim me vitin 2026 dhe në vitin 2028 rriten 0.8% në krahasim me vitin 2027.

Referuar tabelës më sipër rezulton për vitin 2026 të ardhurat nga taksat vendore rriten 0.9% në krahasim me vitin 2025, në vitin 2027 rriten 0.2% në krahasim me vitin 2026 dhe në vitin 2028 rriten 0.3% në krahasim me vitin 2027.

Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2026 pësojnë rritje 2.1% në krahasim me vitin 2025, në vitin 2027 rriten 2.2 % në krahasim me vitin 2026 dhe në vitin 2028 rriten 2.2% në krahasim me vitin 2027.

Të ardhurat e tjera jo tatimore pësojnë ulje në vitin 2026 prej 12.2% dhe rritje për vitet 2027-2028, respektive 2% dhe 2.4%,

Shpenzimet sipas programeve buxhetore (në mijë lekë):

Nr	Programet buxhetore	K.Prog.	2023	2024	2025		2026	2027	2028
			Fakti	Fakti	Plani	Rishikuar	Plani	Plani	Plani
P.1	Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale	AA127	192,120	237,980	341,954	392,930	336,466	323,014	326,800
P.2	Rendi dhe Siguria Publike	AB127	96,466	79,826	125,693	173,070	114,314	115,349	141,153
P.3	Çështjet e Përgjithshme Ekonomike	AC127	80,514	103,122	196,633	228,355	208,399	152,060	154,093
P.4	Infrastruktura, Mjedisi, Transporti dhe Shërbimet Publike	AD127	582,770	840,512	922,670	1,007,499	963,114	1,107,685	1,109,960
P.5	Turizmi dhe Kultura	AE127	34,682	69,075	78,457	89,461	70,563	63,697	66,095
P.6	Arsimi, Rinia dhe Sporti	AF127	288,095	283,217	396,178	503,962	366,210	356,708	358,246
P.7	Përkujdesja Sociale e Strehimi	AG127	57,973	68,393	202,097	204,301	112,581	90,336	90,785
P.8	Fondi Rezervë e Kontigjencës	AH127	0	0	14,000	15,677	16,000	17,000	18,000
TOTALI I SHPENZIMEVE			1,332,619	1,682,125	2,277,682	2,615,255	2,187,647	2,225,849	2,265,132

Shpenzimet sipas strukturës ekonomike (në mijë lekë):

Emri i Artikullit	Kodi Artik.	2023	2024	2025	2025	2026	2027	2028
		Fakti	Fakti	Plani	Rishikuar	Plani	Plani	Plani
Paga&Sigurime (600-601)		581,274.9	666,946.6	861,354.3	927,487.0	864,560.0	868,242.0	873,844.0
Paga & Tjera Personeli	600	498,194.8	571,777.0	738,093.3	795,540.0	740,840.0	743,988.0	748,794.0
Sig.Shoqërore/Shëndetësore	601	83,080.1	95,169.6	123,261.0	131,947.0	123,720.0	124,254.0	125,050.0
Shpenzime Korrente të tjera (602-609, 161, 651)		393,877.7	425,267.5	590,081.0	737,126.0	591,089.0	596,024.0	602,383.0
Mallra dhe Shërbime	602	321,859.4	348,096.6	464,386.0	565,484.0	463,715.0	467,539.0	477,486.0
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	16,054.8	37,476.1	35,760.0	65,905.0	35,760.0	35,760.0	35,760.0
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Buxhetin e Familijve & Individividëve	606	47,603.8	39,694.8	75,935.0	90,059.0	75,614.0	75,725.0	71,137.0
Huamarrje afatgjatë	166	8,177.6	0	0	0	0	0	0
Interesa për Huamarrje	651	182.1	0	0	0	0	0	0
Rezervat	609	0	0	14,000.0	15,677.0	16,000.0	17,000.0	18,000.0

Shpenzime Kapitale (230-232, 255)		357,466.6	589,910.7	826,246.2	950,642.0	731,998.0	761,583.0	788,905.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	8,880.6	10,000.0	13,258.0	0.0	0.0	4,090.0
Aktive të Trupëzuara	231	357,466.6	581,030.1	816,246.2	937,384.0	731,998.0	761,583.0	784,815.0
Transferime Kapitale	232	0	0	0	0	0	0	0
Të dala huadhënie nën-hua.	255	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI		1,332,619.2	1,682,124.8	2,277,681.5	2,615,255.0	2,187,647.0	2,225,849.0	2,265,132.0

Këto shpenzime për vitin 2026 financohen nga të ardhurat e veta në shumën 1,200,606 mijë lekë, nga transfertat e pakushtëzuara në shumën 580,070 mijë lekë dhe nga transfertat sektoriale në shumën 324,898 mijë lekë.

Shpenzimet që financohen nga të ardhurat e veta, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar janë në shumën 1,862,749 mijë lekë dhe zënë 85.15% të shpenzimeve gjithsej, ndërsa shpenzimet që financohen nga transfertat sektoriale janë 324,898 mijë lekë dhe zënë 14.85% e shpenzimeve gjithsej.

Referuar burimeve të mësipërme rezulton se shpenzimet sipas strukturave ekonomike paraqiten si më poshtë;

♦ Shpenzimet gjithsej me burim financimi të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar për vitin 2026 janë 1,862,749 mijë lekë, ku pagat janë 490,746 mijë lekë, të cilat zënë 26.3% të shpenzimeve gjithsej, sigurime shoqërore janë 81,955 mijë lekë, të cilat zënë 4.4% të shpenzimeve gjithsej (paga dhe sigurime zënë 30.7% të shpenzimeve gjithsej), dhe shpenzimet e tjera korrente janë 558,050 mijë lekë, të cilat zënë 30% të shpenzimeve gjithsej, ndërsa shpenzimet për investime janë 731,998 mijë lekë, të cilat zënë 39.3% të shpenzimeve gjithsej.

♦ Shpenzimet me burim financimi nga transfertat sektoriale janë 324.898 mijë lekë, ku pagat dhe sigurimet shoqërore janë 291,859 mijë lekë, të cilat zënë 89.8% të shpenzimeve gjithsej, ndërsa shpenzimet e tjera korrente janë 33,039 mijë lekë, të cilat zënë 10.2% e shpenzimeve gjithsej.

Këto janë të dhënat kryesore për PBA-në 2026-2028, ku në mënyrë të detajuar jepen në raportin shpjegues dhe raportet e PBA-së bashkëlidhur projektvendimit.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

